



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

RREGULLORE DISIPLINORE E FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Prishtinë, 2023

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

PËRMBAJTJA

KREU I. PËRKUFIZIMET 5

NENI 1 5

KREU II. QËLLIMI DHE ZBATIMI 7

NENI 2 - QËLLIMI 7

NENI 3 - ZBATIMI 8

NENI 4 - ZBATIMI BRENDA KLUBEVE 8

NENI 5 - SHTETASIT E JASHTËM 9

NENI 6 - MOSNJOHJA E AKTEVE NORMATIVE 9

NENI 7 - PROCEDURA PENALE 9

KREU III. SHKELJA DISIPLINORE 10

NENI 8 - SHKELJE DISIPLINORE 10

NENI 9 - PERSONI APO ORGANIZATA PËRGJEGJËSE 10

NENI 10 - PËRGJEGJËSIA 11

NENI 11 - PËRJASHTIMET NGA PËRGJEGJËSIA 11

NENI 12 - TENTIMI 12

KREU IV. DËNIMET 13

NENI 13 - QËLLIMI I DËNIMIT 13

NENI 14 - DËNIMET 13

NENI 15 - VËREJTJE (PUBLIKE) 13

NENI 16 - DËNIMI ME TË HOLLA 14

NENI 17 - NDALESA E PRANISË SË SHIKUESVE NË NUMËR TË CAKTUAR TË NDESHJEVE 14

NENI 18 - NDALESA E ZHVILLIMIT TË NUMRIT TË CAKTUAR TË NDESHJEVE NË TERREN 14

TË VET 15

NENI 19 - NDALESA PËR LOJË OSE KRYERJE TË DETYRËS 15

NENI 20 - DËNIMI I NDALESËS SË PËRJETSHME PËR LOJË OSE KRYERJE TË DETYRËS, 15

PËRJASHTIMI NGA GARAT E MËTEJME APO KTHIMI NË RANG MË TË ULËT 16

NENI 21 - BARTJA E DËNIMIT 17

NENI 22 - DËNIMI ME KUSHT 17

KREU V. MATJA E DËNIMIT 18

NENI 23 - RRETHANAT NDIKUESE 18

NENI 24 - RRETHANAT RËNDUESE 18

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





NENI 25 - RRETHANAT LEHTËSUESE	18
NENI 26 - SHKELJE TË SHUMËFISHTA	19
NENI 27 - MATJA E DËNIMIT	20
NENI 28 - SHKELËS I PËRSËRITUR.....	20

KREU VI. SHUARJA, KRYERJA DHE EVIDENTIMI I DËNIMIT 21

NENI 29 - SHUARJA DHE KRYERJA E DËNIMIT	21
NENI 30 - SHLYERJA E DËNIMIT NGA LISTA E TË DËNUARVE	21

KREU VII. PROCEDURA DISIPLINORE DHE ORGANET KOMPETENTE 22

NENI 31 - INICIMI I PROCEDURËS DISIPLINORE.....	22
NENI 32 - PROCEDURA PARAPRAKE	23
NENI 33 - VJETËRSIMI	23
NENI 34 - ORGANET DISIPLINORE.....	23
NENI 35 - KOMISIONI DISIPLINOR	24
NENI 36 - SEANCA DISIPLINORE.....	24
NENI 37 - OBLIGIMI PËR BASHKËPUNIM.....	25
NENI 38 - E DREJTA E DËGJIMIT OSE MBROJTJES ME SHKRIM.....	25
NENI 39 - PEZULLIMI	26
NENI 40 - VENDIMI.....	26
NENI 41 - EVIDENCA DHE MONITORIMI.....	27
NENI 42 - ANKESA NË VENDIMIN E SHKALLËS SË PARË	28

KREU VIII. KËSHILLAT JURIDIKE TË JASHTËZAKONSHME 30

NENI 43 - PËRSËRITJA E PROCEDURËS.....	30
NENI 44 - KËRKESA PËR MBROJTJEN E LIGJSHMËRISË	30
NENI 45 - ZBUTJA E JASHTËZAKONSHME E DËNIMIT	31

KREU IX. SHKELJET DHE DËNIMET DISIPLINORE 32

SHKELJET DHE DËNIMET LIDHUR ME MENAXHIMIN DHE ADMINISTRIMIN E GARAVE TË FBK-SË	32
SHKELJET DHE DËNIMET LIDHUR ME GARAT, DHUNËN DHE DUKURITË E TJERA NEGATIVE NË SPORT.....	38
SHKELJET DHE DËNIMET LIDHUR ME DOPINGUN NË BASKETBOLL.....	42
SHKELJET DHE DËNIMET LIDHUR ME PËRFAQËSUESET	43
SHKELJET DHE DËNIMET PËR DELEGATË DHE GJYQTARË.....	44

KREU X. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT 45

NENI 90 - PROCEDURA E FILLUAR PARAPRAKISHT	45
--	----

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

NENI 91 – RAPORTIMI TEK FIBA	45
NENI 92 – VENDIMET E SHKALLËS SË DYTË	45
NENI 93 – INTERPRETIMI I RREGULLORES	45
NENI 94 – HYRJA NË FUQI	46
NENI 95 – MIRATIMI NGA BORDI	46

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

Në bazë të nenit 23, alinea 1.18. të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Bordi i FBK-së më 30.08.2023 miraton këtë:

RREGULLORE DISIPLINORE TË FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

KREU I. PËRKUFIZIMET

NENI 1

1. Termet dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

1.1. Organizatë e basketbollit - klubet apo shkollat e basketbollit, Shoqata e Trajnerëve të Basketbollit, Shoqata e Gjyqtarëve të Basketbollit, dhe anëtarë të tjerë të Federatës sipas kushteve të caktuara me Statutin e FBK-së dhe aktet e tjera normative;

1.2. Personat zyrtarë të ekipit - çdo person i lidhur direkt ose indirekt me organizatën e basketbollit si p.sh: përfaqësuesi zyrtar, administratorët, menaxherët, drejtuesit, trajnerët, anëtarët e Bordit drejtues, udhëheqësi teknik, mjeku i ekipit dhe mjeku kujdestar, fizioterapi, zyrtari për siguri, personi për kontakt me FBK-në, dhe personat e tjerë të paraqitur në Fletëparaqitjen për Edicionin përkatës apo në Listën paraqitëse (zyrtare/protokoll) të ekipit apo që kryejnë funksion zyrtar apo aktivitete teknik/sportiv në emër të ose brenda fushëveprimit organizativ të organizatës së basketbollit.

1.3. Persona zyrtarë të tjerë - personat pjesëtarë të FBK-së (anëtarët e Bordit, anëtarët e Zyrës Ekzekutive, anëtarët e Komisioneve të FBK-së, etj.), agjentët sportivë, vullnetarët dhe të gjithë ata që janë të ngarkuar me një funksion zyrtar ose një rol tjetër nga FBK.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

- 1.4. Zyrtarë të ndeshjes** - gjyqtarët (kryesorë dhe ndihmës), vëzhguesit, delegatët tavolina zyrtare.
- 1.5. Shikuesit** - personat që kanë përdorur ose kanë një biletë, akreditim, ftesë, ose që në ndonjë mënyrë tjetër marrin pjesë në një ndeshje zyrtare, që përfshijnë:
- a) të gjithë personat që e përcjellin ngjarjen sportive nga tribunat përkatëse, përfshirë këtu hapësirën VIP; dhe
 - b) tifozët si grupe të organizuara të shikuesve të regjistruara si OJQ, të cilat përkrahin ekipet e tyre sportive.
- 1.6. Ndeshje zyrtare** - çdo ndeshje e garës së basketbollit në kuadër të FBK-së.
- 1.7. Person përgjegjës** - personi të cilit i është besuar një lëmi e caktuar e punëve dhe detyrave në organizatën e basketbollit.
- 1.8. FIBA** - Federata Ndërkombëtare e Basketbollit.
- 1.9. WADA** - Agjencia Botërore Anti-Doping.
- 1.10. KosADA** - Agjencia Kosovare Anti-Doping.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:



KREU II. QËLLIMI DHE ZBATIMI

NENI 2 - QËLLIMI

1. Rregullorja Disiplinore e FBK-së (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja) përcakton:

1.1. Përgjegjësitë e lojtarëve, klubeve, personave zyrtarë të klubeve, zyrtarëve të tjerë, zyrtarëve të ndeshjes, anëtarëve të shoqatave të FBK-së, apo cilitdo anëtar që operon brenda FBK-së, për shkelje të rregullave të FBK-së, FIBA-s, WADA-s (Agjencia Botërore Anti-Doping) dhe KosADA-s, në ndeshjet e basketbollit të organizuara nga FBK, FIBA dhe anëtarët e saj;

1.2. Shkeljet dhe dënimet disiplinore, si dhe kushtet e përgjithshme për shqiptimin dhe zbatimin e dënimeve;

1.3. Procedurën disiplinore dhe organet kompetente që vendosin për shkelje disiplinore.

2. FBK mundet me aktet e veta normative të përcaktojë edhe shkelje tjera dhe të përshkruaj dënime për ato shkelje, të parapara me rregulloren e FIBA-s apo me ato të WADA-s dhe KosADA-s.

3. Për çfarëdo shkelje disiplinore që nuk parashikohet shprehimisht si shkelje në këtë Rregullore, por paraqet shkelje të rregullave të tjera të parapara me aktet normative të FBK-së, do të zbatohen dënimet/masat e përshkruara në rregulloren përkatëse. Ndërsa për shkeljet e përcaktuara me këtë Rregullore, zbatohen dënimet e parapara këtu.

4. Kjo Rregullore njihet obligimet sipas Ligjit Nr. 05/L-075 për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive,

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





dhe zbatimi i saj nuk përjashton shqiptimin e masave sipas ligjit në fuqi në Republikën e Kosovës.

NENI 3 - ZBATIMI

1. Dispozitave të kësaj Rregullore i nënshtrohen:
 - 1.1. Sportistët/et e regjistruar/a pranë FBK-së;
 - 1.2. Organizatat e basketbollit, gjegjësisht klubet dhe shoqatat anëtare të FBK-së;
 - 1.3. Anëtarët ose personat zyrtarë të ekipit apo organizatës së basketbollit;
 - 1.4. Personat zyrtarë të tjerë;
 - 1.5. Zyrtarët e ndeshjes.
2. Kjo Rregullore zbatohet pa marrë parasysh se a është kryer shkelja në territorin e Kosovës apo jashtë vendit. Kjo vlen edhe për garat ndërkombëtare, nëse dënimi nuk është shqiptuar në kuadër të rregulloreve të organizatorit të garës ndërkombëtare.
3. Anëtarit të organizatës së basketbollit nuk mund t'i shqiptohet dënimi për shkelje të cilën e ka bërë para se të përcaktohej me këtë Rregullore dhe për të cilën është paraparë dënim me ndonjë akt tjetër.

NENI 4 - ZBATIMI BRENDË KLUBEVE

1. Klubet me aktet e tyre i përcaktojnë çështjet e përgjegjësisë disiplinore për thyerjen e disiplinës në klub. Përgjegjësia për thyerje të disiplinës së klubit nuk e përjashton përgjegjësinë disiplinore sipas kësaj Rregullore dhe anasjelltas.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

2. Dënimet disiplinore të shqiptuara sipas akteve normative të klubit veprojnë vetëm në kuadër të klubit, përveç në rast se është paraparë ndryshe me aktet normative të FBK-së.

NENI 5 - SHTETASIT E JASHTËM

Kjo Rregullore aplikohet edhe për shtetas të jashtëm të cilët janë anëtarë të organizatës së basketbollit, nëse me akte ndërkombëtare nuk është paraparë ndryshe.

NENI 6 - MOSNJOHJA E AKTEVE NORMATIVE

Mosnjohja e akteve normative nuk e përjashton përgjegjësinë në bazë të kësaj Rregullore.

NENI 7 - PROCEDURA PENALE

Fakti që kundërvajtësi është nën hetime apo është dënuar përmes procedurës penale nuk pengon kompetencën FBK-së të veprojë në bazë të kësaj Rregullore, apo anasjelltas.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





KREU III. SHKELJA DISIPLINORE

NENI 8 - SHKELJE DISIPLINORE

1. Shkelje disiplinore është veprimi apo mosveprimi ndaj të cilit parashihet dënim disiplinor sipas kësaj Rregullore, apo dënim sipas akteve tjera normative të FBK-së, FIBA-s, dhe WADA-s/KosADA-s.

NENI 9 - PERSONI APO ORGANIZATA PËRGJEGJËSE

1. Për shkeljet të cilat i shkaktojnë anëtarët e organizatave të basketbollit, do të dënohen organizatat e basketbollit dhe personat përgjegjës në ato organizata, si dhe nxitësi apo ndihmësi i shkeljes së shkaktuar.

2. Organizatat anëtare shkaktojnë shkelje nëse deri te kryerja e saj ka ardhur me veprimin ose lëshimin e kryerjes së veprimit nga ana e organit, personit përgjegjës ose personit tjetër i cili ka qenë i autorizuar të përfaqësoj organizatën, apo nga spektatorët.

3. Përgjegjësia e personit përgjegjës qëndron nëse deri te shkelja ka ardhur me veprimin e tij ose lëshimin e kryerjes së veprimit, pavarësisht nëse këtë e ka bërë me dashje apo nga pakujdesia (neglizhenca). Përgjegjësia e personit përgjegjës nuk përfundon me ndërprerjen e anëtarësisë ose funksionit në organizatën e basketbollit.

4. Nëse në shkeljet e përcaktuara me këtë Rregullore marrin pjesë disa persona, çdo person do të dënohet për shkeljen individualisht.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:



NENI 10 - PËRGJEGJËSIA

1. Personi është përgjegjës kur kryen shkelje me paramendim, nga pakujdesia ose me dashje. Askush nuk mund të konsiderohet shkaktar i shkeljes para se kjo të vërtetohet me vendim të plotfuqishëm të organit meritor.

1.1. Shkelja konsiderohet se është kryer me dashje nëse shkelësi ka qenë i vetëdijshëm për sjelljen e tij dhe ka dashur ta bëjë atë, ose ka qenë i vetëdijshëm se sjellja e tij mund të sjellë pasoja të ndaluara dhe ka pranuar që ajo të ndodhë.

1.2. Shkelja konsiderohet se është kryer nga pakujdesia nëse shkelësi ka qenë i vetëdijshëm se si rezultat i sjelljes së tij mund të lindte një pasojë e ndaluar, por në mënyrë të pakujdesshme ka menduar se nuk do të ndodhë. Pakujdesi konsiderohet edhe nëse kryesi nuk vepron me kujdesin e nevojshëm, me të cilin, sipas rrethanave dhe pozitës, duhet dhe është i aftë ta bëjë.

2. Një shkelje disiplinore mund të kryhet me veprim ose mosveprim. Vepra kryhet me mosveprim nëse shkelësi ka lënë një veprim që duhet ta kishte bërë.

NENI 11 - PËRJASHTIMET NGA PËRGJEGJËSIA

1. Nuk është shkelje, në kuptim të kësaj Rregulloreje, në rast të:

1.1. mbrojtjes së nevojshme, e cila është e domosdoshme për të zmbarsur sulmin real dhe të atëçastshëm ndaj vetes ose personit tjetër, me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi;

1.2. nevojës ekstreme, ku personi e kryen veprën për të zmbarsur prej vetes ose tjetrit rrezikun e atëçastshëm e të paprovokuar, i cili nuk

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

mund të evitohet në mënyrë tjetër, me kusht që dëmi i shkaktuar të mos jetë më i madh se dëmi që është kanosur; ose

1.3. në rast të një **lajthimi faktik ose juridik**, ku personi nuk ka qenë i vetëdijshëm për ndonjë nga tiparet e asaj vepre ose gabimisht ka menduar se ekzistojnë rrethanat, të cilat faktikisht po të ekzistojnë, kjo vepër do të ishte e lejuar, ose për shkaqe të arsyeshme nuk e ka ditur ose nuk ka mundur ta dijë se vepra është e ndaluar.

NENI 12 - TENTIMI

1. Shkelja disiplinore ka mbetur në tentim kur kryesi me qëllim e ka filluar veprimin, por pasoja e dëmshme nuk është shkaktuar.
2. Tentimi ndëshkohet vetëm nëse kjo është paraparë me këtë Rregullore.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:



KREU IV. DËNIMET

NENI 13 - QËLLIMI I DËNIMIT

Dënimet kanë karakter edukues, parandalues dhe korrigjues, dhe shqiptimi i tyre do të ketë gjithmonë qëllimin e mbrojtjes së interesit të përgjithshëm dhe vlerave të sportit të basketbollit.

NENI 14 - DËNIMET

1. Kryerësit së shkeljes mund t'i shqiptohen këto dënime:

- 1.1. Vërejtje (publike) (shih nenin 15);
- 1.2. Dënimi me të holla (shih nenin 16);
- 1.3. Ndalesa e pranisë së shikuesve në numër të caktuar të ndeshjeve (shih nenin 17);
- 1.4. Ndalesa e zhvillimit të numrit të caktuar të ndeshjeve në terren të vet (shih nenin 18);
- 1.5. Ndalesa për të luajtur ose kryer detyrën në numër të caktuar të ndeshjeve apo për periudhë të caktuar kohore (shih nenin 19);
- 1.6. Përrjashtimi nga garat e mëtejme ose kthimi në rang më të ulët (shih nenin 20).

NENI 15 - VËREJTJE (PUBLIKE)

Vërejtja shqiptohet për shkeljen e kryer në rrethana lehtësuese, për të cilën parashihet dënimi me ndalesë loje ose kryerjes së detyrës në numër të caktuar të ndeshjeve, kurse organi procedural do ta vlerësoj se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:



NENI 16 - DËNIMI ME TË HOLLA

1. Dënimi me të holla mund të shqiptohet vetëm ndaj kryerësit të shkeljes, i cili në çfarëdo mënyre gjeneron kompensim financiar në lidhje me sportin e basketbollit.
2. Lartësia e dënimit me të holla për individ mund të jetë prej 100€ deri 3000€, kurse për organizatat (klubet, shoqatat) prej 300€ deri 5000€.
3. Dënimi me të holla duhet paguar në afat prej 30 ditësh nga vendimi i plotfuqishëm, përndryshe personi përgjegjës do të pezullohet deri sa të kryhet pagesa.
4. Dënimet duhet paguar në llogarinë rrjedhëse të FBK-së, dhe konsiderohen si të ardhura të FBK-së.
5. Personat nën moshën 18 vjeçare nuk mund të dënohen me të holla dhe lidhur me çdo dënim të tillë, obligimin do e marr klubi (nëse është e denjë).

NENI 17 - NDALESA E PRANISË SË SHIKUESVE NË NUMËR TË CAKTUAR TË NDESHJEVE

1. Dënimi për ndalesë së pranisë së shikuesve në numër të caktuar të ndeshjeve do të zbatohet kur sjellja e shikuesve, ekipit vendas ose ekipit mysafir, që shkaktoi ndërprerjen e lojës, është konstatuar si shkaktar për shkeljen.
2. Në këtë rast, klubi vendës-organizator duhet të organizojë ndeshje pa prezencën e shikuesve, dhe në atë mënyrë që në ndeshje të jenë të pranishëm vetëm zyrtarët e ndeshjes, personat zyrtarë të klubeve apo FBK-së, kujdestarët, organi për sigurim, dhe përfaqësuesit e mjeteve të

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:



informimit publik. I njëjti obligohet që të siguroj palestrën e regjistruar dhe licencuar për nivelin përkatës të garave.

3. Ky dënim mund të caktohet për një lloj gare, apo për të gjitha llojet e garave të organizuara nga FBK, dhe mund të shqiptohet nga 1 deri në 8 ndeshje.

NENI 18 - NDALESA E ZHVILLIMIT TË NUMRIT TË CAKTUAR TË NDESHJEVE NË TERREN TË VET

1. Dënimi i ndalesës së zhvillimit të ndeshjeve në terrenin e vet i vendoset klubit për një shkëlqje, në rastet kur ndërprerja e ndeshjes u shkaktua nga lojtarët, trajneri, përfaqësuesit zyrtarë të klubit apo turma vendase. Klubi mund të organizojë apo zhvillojë ndeshjen në terren tjetër, siç parashihet me dispozitat e Propozicioneve të Garave përkatëse.

2. Ky dënim mund të shqiptohet nga 1 deri në 8 ndeshje.

NENI 19 - NDALESA PËR LOJË OSE KRYERJE TË DETYRËS

1. Dënimi i ndalesës për lojë apo kryerje të detyrës mund të shqiptohet për numër të caktuar të ndeshjeve apo për një periudhë të caktuar kohore.

2. Dënimi i ndalesës për lojë ose kryerje të detyrës mund të shqiptohet si:

- 2.1.** ndalesë për të gjitha ndeshjet, e të gjitha llojeve të garave; ose
- 2.2.** ndalesë për ndeshje të llojeve të caktuara të garave; dhe
- 2.3.** ndalesë e kryerjes së disa detyrave; ose
- 2.4.** ndalesë e kryerjes së të gjitha detyrave.

3. Dënimi i ndalesës për lojë apo kryerje të detyrës për numër të caktuar të ndeshjeve apo për një periudhë të caktuar kohore përfshin ndalesën e

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





qasjes në palestër të personit përgjegjës në ndeshje/gara/aktivitete të FBK-së gjatë periudhës së dënimit.

4. Dënimi i ndalesës për lojë ose kryerje të detyrës për numër të caktuar të ndeshjeve mund të shqiptohet për më së paku 2 e më së shumti 10 lojë për personin përgjegjës.

5. Dënimi i ndalesës për lojë ose kryerje të detyrës për periudhë të caktuar kohore shqiptohet për muaj të plotë ose vite të plota. Ky dënim mund të shqiptohet nga më së paku 3 muaj, e më së shumti 3 vite. Në raste kur ky dënim i shqiptohet kryerësit të shkeljes i cili mban dënim të mëhershëm, mund t'i shqiptohet dënim unik në kohëzgjatje më shumë se 3 vjet, e më së shumti 4 vjet.

6. Në rast se kryerësi pas dënimit të dytë kryen shkelje të re, mund t'i shqiptohet dënimi i ndalesës së përhershme për lojë ose kryerje të detyrës.

NENI 20 - DËNIMI I NDALESËS SË PËRJETSHME PËR LOJË OSE KRYERJE TË DETYRËS, PËRJASHTIMI NGA GARAT E MËTEJME APO KTHIMI NË RANG MË TË ULËT

1. Dënimi i ndalesës së përhershme për lojë ose kryerje të detyrës, përjashtimi nga garat e mëtejme apo dënim kthimi në rang më të ulët të garave, shqiptohet me rastin e shkeljeve të bëra në rrethana rënduese kur kryerësi i shkeljes ka shprehur vendosmëri, qëndrim, ose ka shkaktuar pasoja të rënda.

2. Për këtë dënim duhet njoftohen edhe FIBA dhe organet gjegjëse të sportit në Kosovë, përfshirë Komitetin Olimpik të Kosovës dhe Ministrinë e Rinisë, Kulturës dhe Sportit.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





NENI 21 - BARTJA E DËNIMIT

Në rast se personi apo organizata e dënuar nuk ka vuajtur dënimin në sezonin aktual ose nuk e ka kryer plotësisht atë, i gjithë dënimi ose pjesa e mbetur e dënimit do të bartet në sezonin e ri të garave.

NENI 22 -DËNIMI ME KUSHT

1. Me rastin e shqiptimit të dënimit ndalesë loje ose kryerje të detyrës për periudhë të caktuar kohore ose dënimit me të holla, organi kompetent mund ta shtyjë kryerjen e dënimit (dënim me kusht) për minimum 6 muaj, e maksimum 2 vjet. Nëse kryerësi në këtë kohë nuk bën shkelje të re, dënimi nuk do të kryhet.
2. Shtyrja e dënimit të shqiptuar do të caktohet nëse në bazë të rrethanave në të cilat është kryer shkelja ose në bazë të sjelljeve të kryerësit së veprës, dhe duke pasur parasysh sjelljen e tij të mëparshme, organi kompetent vlerëson se kryerësi edhe pa shqiptimin e dënimit do të kryej qëllimin e dënimit.
3. Dënim i me kusht revokohet nëse kryerësi i veprës disiplinore gjatë periudhës së provës kryen një ose më shumë vepra të reja, dhe organi kompetent vlerëson se pezullimi i dënimit me kusht është i përshtatshëm.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:



KREU V. MATJA E DËNIMIT

NENI 23 - RRETHANAT NDIKUESE

1. Me rastin e matjes së dënimit merren parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë që dënimi të jetë më i madh ose më i vogël, e veçanërisht:

- 1.1.** pesha e shkeljes dhe pasojat;
- 1.2.** shkalla e përgjegjësisë e kryerësit;
- 1.3.** nxitjet e brendshme;
- 1.4.** rrethanat në të cilat është kryer shkelja;
- 1.5.** qëllimi apo motivi i shprehur;
- 1.6.** sjellja para dhe pas shkeljes;
- 1.7.** vetitë morale dhe qëndrimi i kryerësit pas veprimit të bërë.

2. Organet disiplinore, sipas gjykimit të tyre, vendosin lartësinë e dënimit midis kufirit minimal dhe maksimal të përcaktuar për çdo rast, duke marrë parasysh rrethanat ndikuese dhe parimin e proporcionalitetit.

NENI 24 - RRETHANAT RËNDUESE

Rrethanat rënduese ekzistojnë në rast se personi përgjegjës veçse mban dënim disiplinor të mëhershëm në kohën e shkeljes, nëse shkelja është kryer me paramendim, apo kur ekzistojnë pasoja të rënda ose rrethana tjera nga të cilat shkelja ka marrë formë dhe pasoja të rënda.

NENI 25 - RRETHANAT LEHTËSUESE

1. Rrethanat lehtësuese tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet me një dënim më të butë dhe organi kompetent mund të shqiptojë dënim më të ulët se ai i paraparë me këtë Rregullore.

2. Rrethana lehtësuese ekzistojnë kur kryerësi para shkeljes së bërë:

- 2.1.** ka qenë shembull i sjelljes sportive;
- 2.2.** ka përvojë (stazh) me pjesëmarrje në kombëtare; ose

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:



2.3. ka merita dhe mirënjohje të tjera për zhvillimin e sportit të basketbollit.

3. Pranimi i gabimit nga kryerësi apo provokimi nga pala tjetër duhet të konsiderohen si rrethana lehtësuese.

4. Dënimi me ndalesë loje apo kryerje të detyrës, qoftë për një numër të caktuar të ndeshjeve apo për periudhë të caktuar, ose dënimi me të holla, mund të reduktohen në maksimum deri në gjysmën e dënimit të parashikuar.

NENI 26 - SHKELJE TË SHUMËFISHTA

1. Në rastet e matjes së dënimit për më shumë se një shkelje të cilat vendosen njëkohësisht, së pari përcaktohet dënimi për secilën shkelje veç e veç, kurse pastaj vendoset për dënimin e përgjithshëm, sipas rregullave në vijim:

1.1. Nëse për një shkelje është përcaktuar dënimi i ndalesës së përjetshme për lojë ose kryerje të detyrës, shqiptohet vetëm ky dënim;

1.2. Më shumë dënime për ndalesë loje ose kryerje të detyrës, qofshin për numër të caktuar të ndeshjeve apo për periudhë të caktuar, bashkohen në një dënim i cili patjetër duhet të jetë më i madh se çdo dënim individual i shqiptuar, por nuk mund ta kalojë shumën e të gjitha dënimeve të shqiptuara.

1.3. Nëse për një shkelje shqiptohet dënimi për ndalesë loje ose kryerje të detyrës për numër të caktuar të ndeshjeve, ndërsa për tjetrën për periudhë të caktuar kohore, atëherë shqiptohet dënimi i ndalesës për lojë ose kryerje të detyrës për periudhë të caktuar kohore.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

NENI 27 - MATJA E DËNIMIT

Në rastin kur i shqiptohet dënimi kryerësit i cili është duke kryer dënim të mëhershëm mandatar, organi kompetent këtë dënim do ta konsideroj të përcaktuar, do të mat dënimin për shkeljen e re, pastaj do të shqiptoj dënimin e përgjithshëm, duke vepruar sipas neneve 19 dhe 26 të kësaj Rregulloreje, por që pjesa e mbajtur e dënimit do t'i llogaritet në dënim si pjesë e dënimit të përgjithshëm.

NENI 28 - SHKELËS I PËRSËRITUR

1. Nëse një person shpallet fajtor për më shumë se një shkelje gjatë një periudhe kohore prej dymbëdhjetë (12) muajve do të konsiderohet si një shkelës i përsëritur. Veprat në fjalë nuk duhet të jenë të njëjta ose të ngjashme me njëra-tjetrën.

2. Për veprën e dytë, të tretë dhe për çdo vepër të mëpasshme, sanksioni do të dyfishohet.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





KREU VI. SHUARJA, KRYERJA DHE EVIDENTIMI I DËNIMIT

NENI 29 - SHUARJA DHE KRYERJA E DËNIMIT

1. Dënimi i shqiptuar nuk mund të kryhet nëse kanë kaluar:
 - 1.1. Një (1) vit nga shqiptimi i ndalesës së lojës apo kryerjes së detyrës në numër të caktuar të ndeshjeve;
 - 1.2. Dy (2) vite nga shqiptimi i dënimit për ndalesë loje apo kryerje të detyrës në kohëzgjatje prej një viti;
 - 1.3. Tri (3) vite nga shqiptimi i dënimit për ndalesë loje apo kryerje të detyrës në kohëzgjatje më shumë se një vit;
 - 1.4. Një (1) vit nga shqiptimi i dënimit me të holla.
2. Vjetërsimi i ekzekutimit të dënimit fillon nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit.
3. Kryerja e dënimit kohor ose të dënimit me ndalesë loje apo kryerje të detyrës në numër të caktuar të ndeshjeve nuk vlen për kohën e qëndrimit në burg, apo të qëndrimit dhe lojës jashtë Kosovës.

NENI 30 - SHLYERJA E DËNIMIT NGA LISTA E TË DËNUARVE

Me kalimin e tri (3) viteve nga dita e kryerjes dhe vjetërsimit të dënimit, i dënuari fshihet nga lista e të dënuarve. Dënimi me kusht fshihet nga evidenca me kalimin e një viti nga dita e kalimit të kohës së paraparë për shterje të mbajtjes së dënimit.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:



KREU VII. PROCEDURA DISIPLINORE DHE ORGANET KOMPETENTE

NENI 31 - INICIMI I PROCEDURËS DISIPLINORE

1. Procedura disiplinore mund të iniciohet në bazë të kërkesës (në ueb-faqen e FBK-së) që mund ta paraqes çdo anëtar i FBK-së, person zyrtar i ekipit, organizatë e FBK-së, lojtar i klubit të basketbollit, nëse dëmtohet në interesat dhe të drejtat e tij për shkak të një shkeljeje disiplinore nga cilado organizatë e basketbollit apo anëtarët e asaj organizate, ose nga cilido anëtarë i FBK-së. Kërkesa dorëzohet me shkrim në zyret e FBK-së apo përmes postës elektronike.
2. Me rastin e dorëzimit të kërkesës për inicim, paraqitësi i kërkesës duhet të paguaj në llogari të FBK-së taksën në shumë prej 50 € e cila i kthehet paraqitësit të kërkesës nëse kërkesa është e bazuar. Nëse paraqitësi nuk dëshmon pagesën e taksës, kërkesa nuk do të shqyrtohet.
3. Inicimi i procedurës mund të bëhet edhe në bazë të detyrës zyrtare në FBK (përfshirë këtu Zyrtarin/en për Integritet) në rast të mbrojtjes së interesit së përgjithshëm, me ç'rast nuk paguhet taksa e lartpërmendur.
4. Procedura disiplinore, e cila tashmë është iniciuar, mund të zgjerohet edhe për shkelje të tjera dhe për persona përgjegjës të tjerë, nëse organi kompetent ka mësuar për to në lidhje me zhvillimin e procedurës disiplinore.
5. Komisioni Disiplinor hedh poshtë kërkesën në qoftë se konstatohet se:
 - 5.1. kërkesa është e rrejtshme;
 - 5.2. shkelja e supozuar nuk është paraparë me këtë Rregullore dhe me aktet tjera normative të FBK-së;
 - 5.3. rasti është vjetërsuar;

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:



5.4. shkelja e njëjtë tashmë është trajtuar dhe organet kompetente kanë ardhur me vendim definitiv.

6. Organi kompetent disiplinor duhet të marr vendim jo më vonë se 60 ditë (pune) nga iniciimi i procedurës disiplinore.

NENI 32 - PROCEDURA PARAPRAKE

1. Pas inicimit të procedurës disiplinore, Komisioni Disiplinor, sipas vlerësimit, vendos nëse ka nevojë për procedurë paraprake. Kjo përfshin:

- 1.1.** marrjen e deklaratës nga shkelësi i supozuar dhe nga dëshmitarë të tjerë;
- 1.2.** sigurimin e provave (të tjera); dhe
- 1.3.** marrja e ekspertizave, në rast nevojë.

NENI 33 - VJETËRSIMI

1. Iniciimi i procedurës disiplinore vjetërsohet në kohën prej 6 muajsh, duke llogaritur nga dita kur është bërë shkelja. Për shkeljet lidhur me kurdisjen apo manipulimin e ndeshjeve iniciimi i procedurës disiplinore vjetërsohet në kohën prej 1 viti.

2. Procedura disiplinore nuk mund të zhvillohet nëse në kohëzgjatje prej 6 muajsh nga dita e inicimit të procedurës nuk është marrë vendimi i shkallës së parë.

NENI 34 - ORGANET DISIPLINORE

- 1.** Në bazë të kësaj Rregullore, mund të vendosin këto organe disiplinore:
- 1.1. Komisioni i Garave** - për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi, sipas kompetencave të caktuara me Propozicionet e Garave dhe me Rregulloren për Punën e Komisionit të Garave;
 - 1.2. Komisioni Disiplinor** - si organ i shkallës së parë;

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





1.3. Komisioni Arbitrar – si organ i shkallës së dytë (trajton ankesat në vendimet e Komisionit Disiplinor dhe në vendimet e Komisionit të Garave).

NENI 35 - KOMISIONI DISIPLINOR

1. Në shkallën e parë vendos Komisioni Disiplinor i FBK-së, me përgjashtim të shkeljeve disiplinore të kryera në ndeshje (pjesë e raportit të ndeshjes apo e konstatuar nga video xhirimi), për të cilin vendimin e shkallës së parë e merr Komisioni i Garave, por që ky vendim mund të jetë bazë për iniciimin e procedurës disiplinore për personin/klubin përgjegjës.

2. Komisioni Disiplinor përbëhet prej 3 anëtarëve me të drejtë vote, të cilët i emëron Bordi i FBK-së. Kryetari i Komisionit duhet të ketë eksperiencë ligjore. Komisioni Disiplinor vendos me shumicë votash dhe, sipas nevojës, mund të kërkojë ekspertizë/këshillë për konstatimin ose vlerësimin e një fakti të rëndësishëm nga organi përkatës i FBK-së apo edhe nga ekspertë të tjerë. Ekspertiza shënohet në procesverbal, por mund të paraqitet edhe me shkrim.

3. Anëtarët e Komisionit Disiplinor nuk mund të marrin pjesë në seancë në rast se ka konflikt interesi apo nëse është palë e dëmtuar.

4. Anëtarët e Komisionit Disiplinor obligohen të respektojnë parimin e konfidencialitetit.

NENI 36 - SEANCA DISIPLINORE

1. Pas iniciimit të procedurës disiplinore, në pajtim me anëtarët e Komisionit Disiplinor, Sekretari i Përgjithshëm cakton seancën dhe ftesa u dërgohet anëtarëve të Komisionit përmes postës elektronike, së paku 2 ditë para mbajtjes së seancës.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:



2. Sipas nevojës (në rast se ka procedurë paraprake), ftesa për seancë u dërgohet edhe: parashtruesit të kërkesës, shkelësit të supozuar (në rast të klubit: përfaqësuesit), përfaqësuesit të personit (nëse ka angazhuar të tillë), dëshmitarëve dhe ekspertëve (nëse është e nevojshme).
3. Seanca mbahet në gjuhën shqipe, përveç në rast se ndonjëra palë prezente ka nevojë për përkthim.
4. Në seancë mund të jenë prezent edhe bashkëpunëtorë profesional brenda FBK-së të cilëve u besohet kryerja e disa punëve në procedurën e vendosjes së drejtë, (përfshirë këtu edhe Sekretari i Përgjithshëm i FBK-së), por që nuk gëzojnë të drejtë vote.
5. Komisioni disiplinor vlerëson provat sipas bindjes së lirë.
6. Me rastin e shtyrjes se seancës, caktohet dita dhe ora e vazhimit të saj.
7. Në seancë mbahet procesverbali, të cilin e nënshkruan Kryetari i Komisionit.

NENI 37 - OBLIGIMI PËR BASHKËPUNIM

Të gjitha palët duhet të veprojnë në mirëbesim gjatë procedurës disiplinore. Palët duhet të bashkëpunojnë për të vërtetuar faktet, në përputhje me kërkesat për informacion nga organet e FBK-së.

NENI 38 - E DREJTA E DËGJIMIT OSE MBROJTJES ME SHKRIM

Secili person përgjegjës/klub ndaj të cilit është iniciuar procedurë disiplinore, ka të drejtën e dëgjimit ose të mbrojtjes me shkrim. Nëse ata nuk paraqiten në seancë ose nuk ofrojnë mbrojtje me shkrim, organi kompetent mund të marrë vendim bazuar në të dhënat e mbledhura.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





NENI 39 - PEZULLIMI

1. Pezullimi mund të shqiptohet në rast se ekziston dyshimi i bazuar se kundërvajtësi ka kryer shkelje për të cilën mund t'i shqiptohet:

- 1.1. dënimi i ndalesës për lojë apo për kryerje të detyrës për periudhë të caktuar; ose
- 1.2. dënimi i përjetshëm për lojë ose për kryerje të detyrës.

2. Pezullimin e shqipton Komisioni Disiplinor, dhe normalisht mund të zgjasë deri në dy (2) muaj, ndërsa në rastet më të ndërlikuara apo ndjeshme deri në marrjen e vendimit të shkallës së parë. Koha e kaluar në pezullim llogaritet në dëm. Për vendimin për pezullim njoftimi bëhet përmes ueb faqes zyrtare të FBK-së, apo në raste më të ndjeshme përmes postës elektronike vetëm tek palët me interes.

3. Në rastin e përjashtimit të lojtarit në lojë, paraqitja nga ana e delegatit apo gjyqtarëve sjell pezullimin e menjëhershëm. Pezullimi i menjëhershëm zgjat më së shumti një lojë.

4. Vendimet për pezullim dhe dënim ndalesë loje apo kryerje të detyrës të përjetshëm të marra nga organi përkatës i FIBA-s/WADA-s/KosADA-s janë të detyrueshme për FBK.

NENI 40 - VENDIMI

1. Komisioni Disiplinor mund të nxjerr vendim për:

- 1.1. pezullim të procedurës;
- 1.2. lirimin e shkelësit të supozuar nga përgjegjësia;
- 1.3. shqiptimin e masave/dënimeve disiplinore.

2. Organi disiplinor vendos me vendim të shkruar, i cili përmban:

- 2.1. **Hyrje**, ku shënohet emri i plotë i lëndës, emri i organit që vendos, si dhe data e marrjes së vendimit;

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:



- 2.2. Vendimin**, ku shënohet ndaj kujt dhe çfarë mase disiplinore është shqiptuar; gjegjësisht se a është liruar shkelësi nga përgjegjësia;
- 2.3. Arsyetimin e vendimit**, në të cilin shpalosen faktet mbi të cilat Komisioni është bazuar, kompetenca e organit disiplinor, dhe meritat e vendimit;
- 2.4. Këshillë juridike**, në të cilën shënohet emërtimi i organit të shkallës së dytë i cili vendos për Ankesën si dhe afati i kundërshtimit.

3. Vendimi i përcillet të dënuarit; klubit të tij/saj (nëse është dënuar lojtari/ja apo anëtar i klubit); paraqitësit të kërkesës, anëtarëve të organit disiplinor që ka marr vendim (dhe në rast të ankesës, anëtarëve të organit të cilit i është sfiduar vendimi); dhe FIBA-s në rast se është shqiptuar dënim kohor për ndalesë loje apo kryerje të detyrës ose dënimi i ndalesës së përhershme për lojë ose kryerje të detyrës.

4. Gabimet tipografike, numerike ose gabimet e tjera të dukshme në vendim mund të korrigjohen sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të pjesëmarrësve në procedurë, dhe më pas t'u komunikohen të gjithë palëve/pjesëmarrësve me shkrim.

NENI 41 - EVIDENCA DHE MONITORIMI

- 1.** FBK do të mbajë evidencën e plotë në formë elektronike të dënimeve të shqiptuara në bazë të kësaj Rregullore, dhe do ta vë në dispozicion të palëve me interes, sipas kërkesës.
- 2.** Vendimet e organit kompetent do të ruhen në arkivën e FBK-së dhe do publikohen edhe në faqen zyrtare të FBK-së, përveç në raste të ndjeshme ku vendimi u dërgohet vetëm palëve të interesit.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





3. Komisioni i Garave apo organet/personat zyrtarë të FBK-së që kanë kompetenca rreth menaxhimit dhe mbarëvajtjes të garave do të monitorojnë ekzekutimin/kryerjen e dënimeve.

NENI 42 - ANKESA NË VENDIMIN E SHKALLËS SË PARË

1. Kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të shkallës së parë mund të parashtrahet ankesë në afat prej 3 ditë (pune), duke llogaritur nga dita e përcjelljes së vendimit përmes postës elektronike, kurse i paraqitet Komisionit Arbitrar. Me rastin e paraqitjes së ankesës, paraqitësi duhet të paguaj në llogari të FBK taksën prej 300€, mjete të cilat i kthehen paraqitësit nëse i miratohet ankesa.

2. Ankesën mund ta bëjë paraqitësi i kërkesës, personi të cilit i është shqiptuar dënimi, klubi i dënuar, dhe klubi për lojtarin apo funksionarin e dënuar. Nëse pala e pakënaqur bashkë me ankesën nuk e paraqet edhe dëshminë për taksën e paguar, ankesa nuk do të shqyrtohet.

3. Nëse është shqiptuar dënimi i përjetshëm për ndalesë loje apo kryerje të detyrës, ose dënimi për ndalesë loje apo kryerje të detyrës për më shumë se një vit, kurse vendimi i tillë konfirmohet nga organi gjegjë i shkallës së dytë, kundër këtyre vendimeve mund t'i paraqitet ankesë Kuvendit të FBK-së në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të vendimit të shkallës së dytë përmes organit të shkallës së dytë, por që ankesa nuk e ndalon ekzekutimin.

4. Nëse ankesën e ka paraqitur i dënuari, vendimi i shkallës së parë nuk mund të ndryshohet në dëm të tij. Ankesa e paraqitur ndalon ekzekutimin e vendimit, përpos në rastet e parapara nga neni 42.3, si dhe paraqitja e ankesës për vendimin mbi pezullim.

5. Organi disiplinor i shkallës së dytë mund të:

5.1. vërtetojë vendimin e organit paraprak;

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

- 5.2.** të miratojë ankesën, dhe të refuzoj vendimin organit paraprak;
5.3. të miratojë ankesën, dhe të ndryshoj (pjesërisht) vendimin e organit paraprak.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





KREU VIII. KËSHILLAT JURIDIKE TË JASHTËZAKONSHME

NENI 43 - PËRSËRITJA E PROCEDURËS

1. Përsëritja e procedurës mund të kërkohej nëse:
 - 1.1. ekziston dyshimi i bazuar që vendimi është marrë në bazë të fakteve të rrejshme apo falsifikuara;
 - 1.2. ekzistojnë faktet dhe dëshmitë e reja të cilat më herët nuk janë ditur, e të cilat do të ndikonin me rastin e vendosjes;
 - 1.3. nuk janë respektuar rregullat e procedurës së seancës, sidomos nëse personit nuk i është dhënë mundësia e mbrojtjes.
2. Propozimin për përsëritjen e procedurës mund ta paraqesin:
 - 2.1. i dënuari;
 - 2.2. klubi, nëse është dënuar lojtari apo funksionari i tij;
 - 2.3. paraqitësi i kërkesës.
3. Propozimi për përsëritjen e procedurës paraqitet në afat prej 3 muaj duke llogaritur nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit. Për propozimin për përsëritjen e procedurës vendos organi të cilit i kontestohet vendimi.

NENI 44 - KËRKESA PËR MBROJTJEN E LIGJSHMËRISË

1. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të bëhet për shkak të shkeljeve materiale ose procedurale të kësaj Rregullore ose rregulloreve tjera, nëse këto shkelje kanë cenuar ligjshmërinë e vendimit të nxjerrë.
2. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të parashtrohet nga personi i cili ka të drejtë ankese kundër vendimit.
3. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të bëhet brenda tre (3) muajve nga data e plotfuqishmërisë së vendimit.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:



4. Për kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë vendos Kuvendi i radhës i rregullt i FBK-së. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të refuzohet apo pranohet, me këtë rast vendimi i plotfuqishëm anulohet kurse lënda kthehet në rishqyrtim dhe vendosje.

NENI 45 - ZBUTJA E JASHTËZAKONSHME E DËNIMIT

1. Zbutja e dënimit të shqiptuar lejohet nëse pas përfundimit të formës së prerë të vendimit, dalin rrethana që nuk kanë ekzistuar në kohën e shqiptimit të vendimit ose nuk dihet për të, por që dukshëm do të ndikonin në shqiptimin e dënimit.

2. Kërkesa për ulje të jashtëzakonshme të dënimit mund të parashtrohet nëse kryesi i veprës disiplinore tashmë e ka vuajtur së paku gjysmën e dënimit.

3. Kërkesa i paraqitet organit disiplinor që ka dhënë vendimin, i cili pas shqyrtimit i'a dërgon të gjithë dosjen me këshillën e tij për vendim Kuvendit të FBK-së. Kuvendi mund të refuzojë kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, ose ta pranojë kërkesën dhe me vendim të liroj të dënuarin nga vuajtja e mëtejme e dënimit ose t'ia zbut dënimin në rast se ekzistojnë rrethanat për një vendim të tillë.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:



KREU IX. SHKELJET DHE DËNIMET DISIPLINORE

SHKELJET DHE DËNIMET LIDHUR ME MENAXHIMIN DHE ADMINISTRIMIN E GARAVE TË FBK-SË

NENI 46 – SHKELJET

1. Shkelje të rënda në lidhje me menaxhimin dhe administrimin e garave konsiderohen këto si në vijim:

- (a) Mos-zbatimi i vendimeve të organeve të FBK-së, përfshirë këtu çfarëdo veprimi (të drejtpërdrejtë apo tërthorazi) kundër vendimeve të organeve të FBK-së që në një mënyrë apo tjetër rrezikon autoritetin dhe efikasitetin e atyre organeve.
- (b) Mos-përmbushja e obligimeve dhe detyrave ndaj FBK-së sipas Statutit dhe akteve tjera normative, apo obligimeve që rrjedhin nga një marrëveshje mes dy palëve, përfshirë këtu por duke mos u kufizuar në Marrëveshjet mbi të Drejtat dhe Transmetimet Audio-vizuale dhe Marrëveshjet e Sponsorizimit.
- (c) Dhënia e dëshmime/deklaratave të rrejshme në procedurë para organeve të FBK-së, me anë të së cilës mashtrohen organet e federatës (trupat ose funksionarët në këto organe) dhe si rrjedhojë merret një vendim që nuk do të ishte marrë ndryshe.
- (d) Deklaratat publike, duke përfshirë ato të bëra në rrjete sociale ose ndonjë tjetër mjet komunikimi, nga çdo person që ndërmerr aktivitete drejtuese, teknike ose sportive në emër të klubeve, që nxisin dhunë; dëmtojnë imazhin ose interesat e garave të basketbollit të FBK-së; rrezikojnë marrëdhëniet harmonike ndërmjet klubeve; tregojnë mungesë respekti; japin mesazh diskriminues ose fyes; dhe në përgjithësi çdo deklaratë të dëmshme për sportin e basketbollit.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





- (e)** Kryerja fshehtas e ndonjë detyre lidhur me sportin e basketbollit në rastet kur personi është i dënuar ose pezulluar me vendim të plotfuqishëm nga organet e FBK-së.
- (f)** Parashtrimi i shënimeve të rrejshme ose dokumenteve të falsifikuara për regjistrimin e lojtarit para organeve përkatëse të FBK-së.
- (g)** Paraqitja e lojtarit për skuadrën në ndeshjet zyrtare të FBK-së, për të cilin është konstatuar se është regjistruar me shënime të rrejshme ose dokumente të falsifikuara, me ç' rast mund të dënohet edhe Lojtari apo Trajneri nëse kanë qenë në dijeni për këtë.
- (h)** Kalimi i Lojtarit në klub tjetër pa pëlqimin e klubit të vet.
- (i)** Inkuadrimi i lojtarit nga ekipi tjetër pa pëlqimin e ekipit.
- (j)** Nënshkrimi i Lojtarit për dy ose më shumë klube në afatin kalimtar, gjegjësisht nënshkrimi i më shumë se një marrëveshje valide me klube të ndryshme.
- (k)** Pranimi i deklaratës për kalim të lojtarit ose nënshkrimi i marrëveshjes me atë lojtar, në rastet kur Klubi ka qenë në dijeni se lojtari ka dhënë pëlqimin klubit tjetër ose që ka marrëveshje të vlefshme me klubin tjetër.
- (l)** Mos-përmbushja e detyrimeve kontraktuale ndërmjet subjekteve të sportit të basketbollit (mos-përmbushja e kontratës së klubit me lojtarin, mos-përmbushja e detyrimeve kontraktuale në lidhje me kompensimin ndërmjet klubeve, etj.), por vetëm në lidhje me kontratat/marrëveshjet e depozituara pranë FBK-së.
- (m)** Tërheqja pa arsye nga garat nga Klubi.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:



- (n) Braktisja e lojës pa arsye nga një ekip pasi të ketë filluar loja, e që pengon përfundimin e saj.
- (o) Pjesëmarrja e një Klubi i cili gjendet nën pezullim në ndeshje publike.
- (p) Dështimi për të zbatuar të gjitha masat e nevojshme parandaluese për të shmangur shqetësimet apo trazirat, para, gjatë ose pas një loje, ose çdo situatë përfshirë mbi-kapacitetin që rrezikon mirëqenien dhe sigurinë e të pranishmëve, ose mungesa e forcave të sigurisë apo pasiviteti i personelit të sigurisë në palestër.
- (q) Largimi ose lëshimi i garave zyrtare në kategoritë e reja me ekipet e juniorëve, kadetëve, dhe pionerëve nga një Klub i Superligës.
- (r) Mos-paraqitja me kohë e vendit dhe kohës për zhvillimin e ndeshjes nga Klubi.

2. Shkelje të tjera në lidhje me menaxhimin dhe administrimin e garave konsiderohen këto si në vijim:

- (a) Sjellja në mënyrë të pahijshme dhe josportive, ose refuzimi pa arsye i ftesës, në rastet kur personi thirret para organeve të FBK-së.
- (b) Mungesa e bashkëpunimit, konsideratës apo respektit, ose komentet përçmuese publike duke përfshirë ato të bëra në rrjete sociale apo çdo mjet komunikimi, drejt garave të FBK-së; një tjetër klubi dhe përfaqësuesit/drejtuesit/anëtarit të tyre; ose ndaj çdo personi ose subjekti që ndërmerr një veprimtari teknike ose sportive brenda një organizate basketbolli.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:



- (c) Deklarata publike, përfshirë ato të bëra në rrjetet sociale ose çdo mjet komunikimi, që lidhen me performancën e gjyqtarëve ose ndonjë zyrtari të ndeshjes.
- (d) Inkuadrimi nga Klubi i lojtarit pa kontroll mjekësor, ose kur pjesëmarrja është ndaluar nga ana e mjekut.
- (e) Zhvillimi i ndeshjeve në Kosovë me ekipe të jashtme, pa pëlqimin e organeve kompetente të FBK-së.
- (f) Çdo sjellje josportive që nuk përcaktohet në alinetë paraprake.

NENI 47 – DËNIMET

1. Dënimet që mund të shqiptohen ndaj **individëve** për shkeljet e përcaktuara në nenin 46 janë:

1.1. Dënimet për **shkeljet e rënda**:

- (a) Ndalesë loje apo kryerje të detyrës për periudhë të caktuar nga gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet;
- (b) Ndalesë e përhjetshme për lojë apo kryerje të detyrës.

1.2. Dënimet për **shkeljet e tjera**:

- (a) Vërejtje;
- (b) Ndalesë loje apo kryerje të detyrës për numër të caktuar të ndeshjeve, më së paku 2 e më së shumti 10 lojë;
- (c) Ndalesë loje apo kryerje të detyrës për periudhë të caktuar nga gjashtë një (1) muaj deri në tre (1) vjet.

2. Dënimet që mund të shqiptohen ndaj **organizatës së basketbollit** për shkeljet e përcaktuara në nenin 46 janë:

2.1. Dënimet për **shkeljet e rënda**:

- (a) Dënim me të holla në lartësi prej 1,500.00 EUR deri në 5,000.00 EUR;

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





- (b) Ndalesa e prezencës së shikuesve në numër të caktuar ndeshjes, prej 1 deri në 8 ndeshje;
- (c) Ndalesa e zhvillimit të ndeshjeve në terrenin e vet, prej 1 deri në 8 ndeshje;
- (d) Përrjashtimi nga garat e mëtejme;
- (e) Kthim në rang më të ulët.

2.2. Dënimet për **shkeljet e tjera**:

- (a) Dënim me të holla në lartësi prej 300.00 EUR deri në 2,000.00 EUR;
- (b) Ndalesa e prezencës së shikuesve në numër të caktuar ndeshjes, prej 1 deri në 4 ndeshje.

3. Si dënim specifik në rast të mos-përmbushjes së obligimeve financiare ndaj FBK-së, Klubi nuk mund të garojë në edicionin e ardhshëm/vijues, gjegjësisht deri në përmbushjen e të gjitha obligimeve financiare.

4. Si dënim specifik në rast të konstatimit se një lojtar është regjistruar me shënime të rrejshme ose dokumente të falsifikuara, klubit ose shkollës së basketbollit automatikisht i shlyhen të gjitha rezultatet e arritura, përjashtohet nga gara për vitin garues në vijim dhe edicionin e ardhshëm.

5. Si dënim specifik në rast se Klubi i cili e ka fituar titullin e kampionit, në cilindo çast kur konstatohet se në skuadër e ka aktivizuar lojtarin e regjistruar me shënime të rrejshme ose dokumente të falsifikuara, Klubi do të dënohet me marrjen e titullit të kampionit.

6. Në rast të refuzimit ose mosparaqitjes në lojë apo braktisjes së lojës pa arsye pasi të ketë filluar loja, aplikohen **dënimet specifike** si në vijim:

- 6.1.** Në rast se një Klub pa arsye nuk paraqitet në lojë ose në mënyrë të pajustificuar refuzon të marrë pjesë në lojë, Klubit do i regjistrohet humbja me rezultat zyrtar zero-njezet (0-20). Në fazën e playoff,

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





humbja automatike do të sjellë edhe humbjen e serisë dhe në vitin e ardhshëm garues do të paraqitet në një rang më të ulët garimi.

6.2. Në rast se Klubi braktis pa arsye lëshon zonën e lojës pasi të ketë filluar loja, duke penguar kështu përfundimin e lojës, Klubit do i regjistrohet humbja me rezultat zyrtar zero-njëzet (0-20), përveç në rast se Klubi kundërshtar kishte një rezultat më të favorshëm kur ka ndodhur ngjarja. Në fazën e playoff, humbja automatike do të sjellë edhe humbjen e serisë dhe në vitin e ardhshëm garues do të paraqitet në një rang më të ulët garimi.

6.3. Përveç humbjes me rezultat zyrtar sipas nenit 47 alineja 6.1 ose 6.2, organi kompetent mund të shqiptojë edhe dënime me të holla prej 5,000.00 EUR.

7. Si **dënim specifik** në rast të largimit apo lëshimit të garave në kategoritë e reja me ekipet e juniorëve, kadetëve, dhe pionerëve nga një Klub i Superligës, Klubi do të dënohet me të holla në lartësi prej 5,000.00 EUR për secilën kategori.

8. Për dënimet e shqiptuara ndaj organizatës së basketbollit sipas nenit 47.2, mund të shqiptohet dënim ndalesë loje apo kryerje të detyrës për periudhë prej tre (3) muaj deri në një (1) vit edhe për personin përgjegjës.

9. Për dënimet e shqiptuara ndaj individëve sipas nenit 47.1 dhe 47.4, mund të shqiptohet dënim me të holla në lartësi prej 300.00 EUR deri në 3,000.00 EUR edhe për Klubin.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





SHKELJET DHE DËNIMET LIDHUR ME GARAT, DHUNËN DHE DUKURITË E TJERA NEGATIVE NË SPORT

NENI 48 – SHKELJET

1. Shkelje të rënda në lidhje me garat, dhunën dhe dukuritë e tjera negative në sport konsiderohen këto si në vijim:

- (a) Nxitja e garuesit ose anëtarit të klubeve për mos-pjesëmarrje të ekipeve; mos-paraqitje në përbërjen më të fortë, mos-angazhim; të mos luajnë ashtu siç dijnë; apo të lëshojnë fushën e lojës.
- (b) Nxitja me shpërblime, dhurata ose në mënyrë tjetër që ndikon tek gjyqtarët, delegatët ose tek Komesarët, që detyrën e vet të mos e kryejnë në frymën e rregullave të basketbollit.
- (c) Ndikimi apo pjesëmarrja në kurdisje apo manipulim të rezultatit në ndeshje/gara të basketbollit, duke përfshirë shpërndarjen e informacioneve konfidenciale që mund të përdoren më pas për kurdisje apo manipulim (çdo informacion në lidhje me ndonjë garë që personi zotëron si rrjedhojë e pozitës së tij në lidhje me garat e basketbollit, duke përjashtuar informacionet tashmë të publikuara ose që janë lehtësisht të arritshme apo zbulohen në përputhje me rregulloret në fuqi).
- (d) Dështimi për të raportuar ndonjë aktivitet të dyshimtë në lidhje me kurdisjet apo manipulimin e ndeshjeve.
- (e) Dështimi për të bashkëpunuar në një hetim, pengimi ose vonimi i hetimit duke fshehur, ngatërruar ose shkatërruar dokumentacion ose informacion që mund të jetë me rëndësi për hetimin e rasteve të mundshme të kurdisjes apo manipulimit të ndeshjeve.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:



- (f)** Sulmi fizik ndaj çdo pjesëmarrësi në ngjarjen sportive, qofshin pjesëmarrës të drejtpërdrejtë të ngjarjes sportive apo shikues, ose përleshja fizike mes pjesëmarrësve apo shikuesve - tifozëve.
- (g)** Fyerja, provokimi, ose kanosja drejtuar garuesit, trajnerit, zyrtarit të ekipit, gjyqtarit, Komesarit, delegatit, zyrtarëve të tjerë të ndeshjes, apo shikuesit në lojë ose jashtë terrenit të basketbollit.
- (h)** Shfaqja e agresivitet që reflektohet në sjellje josportive, brohoritje ofenduese, kërcënime, përpjekje fizike për të penguar rrjedhën normale të lojës, duke ushtruar në këtë mënyrë një lloj dhune me qëllim që të shkaktohet ndërprerja e lojës ose të rrezikohet siguria personale e kundërshtarit, lojtarëve ose zyrtarëve.
- (i)** Ofendimi, qoftë në fushën e lojës apo përmes rrjeteve sociale, i një tjetri në bazë të përkatësisë etnike, racore, gjuhësore, religjioze, gjinore, politike, apo për arsye tjera.
- (j)** Veprimet kërcënuese, diskriminuese, poshtëruese ose degraduese ndaj një zyrtari të ndeshjes, apo cilitdo person tjetër në palestër.
- (k)** Diskriminimi në bazë të orientimit seksual, politik, apo në bazë të racës ose fesë, e shfaqur me veprime ose sjellje abuzive e të pandjeshme.
- (l)** Dëmtimi i objektit të sportit, pajisjeve sportive, instalimeve dhe pajisjeve të tjera në objektin sportiv.
- (m)** Gjuajtja e sendeve në terrenin e lojës ose në tribunat e shikuesve - tifozëve; futja dhe përdorimi i mjeteve piroteknike, mjeteve të

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





forta dhe mjeteve tjera në objektet sportive, përdorimi i të cilave mund të shkaktojnë pasiguri të pjesëmarrësve në ngjarjet sportive.

- (n) Ngacmimi apo sjellja e padëshiruar ndaj tjetrit e kryer pa pëlqim ose me forcë, kërcënim, kanosje, shtrëngim ose manipulim.
- (o) Të gjitha veprimet dhe çdo lloj sjelljeje që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nxisin dhunë apo urrejtje e që mund të sjellin deri të sulmet fizike apo dhuna.

2. Shkelje të tjera në lidhje me garat, dhunën dhe dukuritë e tjera negative në sport konsiderohen këto si në vijim:

- (a) Ndërmarrja e veprimeve që shkaktojnë ndërprerjen e përkohshme të një loje, e që nuk dënohet si shkelje e rëndë si më lartë.
- (b) Ofendimi ose veprime që tregojnë mungesë respekti ndaj një anëtarit të ekipit, një tjetër individit, publiku, apo çdo person tjetër, e që nuk përbën një shkelje të rëndë.
- (c) Mosrespektimi ose protesta e përsëritur ndaj urdhrave dhe udhëzimeve të zyrtarëve të ndeshjes.
- (d) Tentimi për agresion apo sulm fizik ndaj çdo pjesëmarrësi në ngjarjen sportive, qofshin pjesëmarrës të drejtpërdrejtë të ngjarjes sportive apo shikues.
- (e) Nxitja ose provokimi i të tjerëve, qofshin ata shikues, sportistë ose zyrtarë të ekipit, goftë për shkak të mënyrës së lojës së tij, ose duke fyer, duke dhënë vërejtje, duke bërë gjeste, duke u sjellë apo reaguar në mënyrë të ashpër, ose duke iu afruar sportistëve

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





ose zyrtarëve të klubit kundërshtar apo edhe zyrtarëve të ndeshjes.

- (f) Sjellja josportive e Lojtarit apo trajnerit që është larguar nga bankina.

NENI 49 – DËNIMET

1. Dënimet që mund të shqiptohen ndaj **individëve** për shkeljet e përcaktuara në nenin 48 janë:

1.1. Dënimet për **shkeljet e rënda**:

- a) Ndalesë loje apo kryerje të detyrës për periudhë të caktuar nga gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet;
- b) Ndalesë e përfjetshme për lojë apo kryerje të detyrës.

1.2. Dënimet për **shkeljet e tjera**:

- a) Vërejtje;
- b) Ndalesë loje apo kryerje të detyrës për numër të caktuar të ndeshjeve, prej 1 deri në 4 ndeshje;
- c) Dënim me të holla, në lartësi prej 100.00 EUR deri në 3,000.00 EUR.

2. Dënimet që mund të shqiptohen ndaj **organizatës së basketbollit** për shkeljet e përcaktuara në nenin 48 janë:

2.1. Dënimet për **shkeljet e rënda**:

- a) Dënim me të holla në lartësi prej 2,000.00 EUR deri në 5,000.00 EUR;
- b) Kthimi në rang më të ulët të garave;
- c) Ndalesa e pranisë së shikuesve për numër të caktuar të ndeshjeve, prej katër (4) deri në tetë (8) ndeshje;
- d) Ndalesa e lojës në terrenin e vet për një numër të caktuar të ndeshjeve, prej katër (4) deri në tetë (8) ndeshje.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





2.2. Dënimet për shkeljet e tjera:

- a) Dënim me të holla në lartësi prej 500.00 EUR deri në 3,000.00 EUR;
- b) Ndalesa e pranisë së shikuesve për numër të caktuar të ndeshjeve, prej një (1) deri në katër (4) ndeshje;
- c) Ndalesa e lojës në terrenin e vet për një numër të caktuar të ndeshjeve, prej një (1) deri në katër (4) ndeshje.

SHKELJET DHE DËNIMET LIDHUR ME DOPINGUN NË BASKETBOLL

NENI 50 – SHKELJET DHE DËNIMET

1. Lojtari i cili përdor ndonjë substancë dhe/ose metodë të ndaluar, do të dënohet nga trupi kompetent, siç është paraparë me Rregulloren për Anti-Doping në Basketboll, rregullat dhe Rregulloren e KosADA dhe me rregullat ndërkombëtare mbi anti-dopingun.

2. Sportisti, zyrtari i ekipit apo i FBK-së, zyrtari i ndeshjes, apo ndonjë anëtarë tjetër i FBK-së, i cili shpërndan ndonjë substancë, ose lejon apo në çfarëdo mënyre inkurajon lojtarin të marrë ndonjë substancë të ndaluar apo të përdorë metodë të ndaluar, do të dënohet nga trupi kompetent, siç është paraparë me Rregulloren për Anti-Doping në Basketboll, rregullat dhe Rregulloren e KosADA dhe me rregullat ndërkombëtare mbi anti-dopingun.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:



SHKELJET DHE DËNIMET LIDHUR ME PËRFAQËSUESET E KOSOVËS

NENI 51 - SHKELJET

1. Shkelje në lidhje me përfaqësueset e Kosovës konsiderohen këto si në vijim:

- a) Lojtari i cili pa arsye vonohet, refuzon pjesëmarrjen në përfaqësuese, ose pa arsye nuk paraqitet në përgatitjet e përfaqësueses (përfshirë seancat stërvitore).
- b) Lojtari i cili ndërhyt apo kundërshton vendimet, planet, apo sistemin e lojës së trajnerit të përfaqësueses, apo sfidon autoritetin e trajnerit ose përndryshe cenon unitetin ose disiplinën brenda përfaqësueses.
- c) Lojtari apo funksionari i cili merr pjesë në përfaqësuese ose në ndeshje ndërkombëtare, me veprimet e veta dëmton autoritetin e sportit të basketbollit.

NENI 52 – DËNIMET

1. Dënimet që mund të shqiptohen ndaj **individëve** për shkeljet e përcaktuara në nenin 51 janë:

- a) Vërejtje;
- b) Ndalesë loje apo kryerje të detyrës për periudhë të caktuar kohore, prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.

2. Si **dënim specifik** në rast se vonesa apo mos-ardhja e lojtarit ka ndodhur me fajin e klubit, apo në rast se klubi jep justifikime të rrejshme për të shmangur thirrjen për përfaqësuese, ose nxit lojtarin të refuzoj apo të mos paraqitet, klubit do t'i shqiptohet dënim me të holla, në lartësi prej 500.00 EUR deri në 5,000.00 EUR.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:



SHKELJET DHE DËNIMET PËR DELEGATË DHE GJYQTARË

NENI 53 - SHKELJET

1. Shkelje veçanërisht në lidhje me delegatin apo gjyqtarin konsiderohen këto si në vijim:

- a) Delegati dhe gjyqtari të cilët me papërgjegjësi, pakujdesi, dhe anagazhim të pamjaftueshëm e kryejnë detyrën.
- b) Delegati ose gjyqtari i cili pa arsye valide vonohet ose nuk paraqitet në ndeshje.
- c) Delegati apo gjyqtari i cili tenton të sulmoj fizikisht cilindo pjesëmarrës ose shikues në ndeshje apo edhe jashtë palestrës.
- d) Delegati apo gjyqtari i sulmon fizikisht cilindo pjesëmarrës ose shikues në ndeshje apo edhe jashtë palestrës.

NENI 54 - DËNIMET

1. Dënimet që mund të shqiptohen ndaj **individëve** për shkeljet e përcaktuara në nenin 53 janë:

- a) Vërejtje;
- b) Ndalesë loje apo kryerje të detyrës për numër të caktuar të ndeshjeve nga një (1) deri në tri (3) ndeshje;
- c) Ndalesë loje apo kryerje të detyrës për periudhë të caktuar nga gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet;

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:



KREU X. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

NENI 90 - PROCEDURA E FILLUAR PARAPRAKISHT

1. Procedura disiplinore e filluar para hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore, e cila nuk ka përfunduar në marrjen e vendimit për dënim, do të vazhdohet sipas dispozitave të kësaj Rregullore, nëse ato nuk parashohin dënim më të butë për atë shkelje.

2. Nëse për zhvillimin e procedurës disiplinore para hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore ka qenë kompetent organi tjetër disiplinor, vazhdimin e mëtejme të procedurës e bënë organi kompetent në bazë të kësaj Rregullore.

NENI 91 - RAPORTIMI TEK FIBA

Në lidhje me vendimet për ndalesë kohore për lojë apo kryerje të detyrës, dhe ndalesë të përjetshme për lojë apo kryerje të detyrës, FBK do të informoj FIBA-n. Nëse kjo e fundit kërkon, FBK do të siguroj se dosja e plotë mbi vendimin të jetë në dispozicion të FIBA-s.

NENI 92 - VENDIMET E SHKALLËS SË DYTË

Vendimet e arbitrazhit janë definitive, dhe kundër tyre nuk është e lejuar ankesa brenda FBK-së, përpos rasteve sipas nenit 44 të kësaj Rregullore. Palët e pakënaqura me vendimin e Komisionit Arbitrar kanë të drejtë të ankesës te Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS) dhe në Gjykatën kompetente përkatëse.

NENI 93 - INTERPRETIMI I RREGULLORES

Interpretimin e dispozitave të kësaj Rregullore e bënë Bordi i FBK-së, në pajtim me frymën e përcaktuar dhe miratuar nga Bordi i FBK-së.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

NENI 94 - HYRJA NË FUQI

Ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore, bie nga fuqia Rregullorja Disiplinore e cila ka qenë në fuqi para miratimit të kësaj Rregullore.

NENI 95 - MIRATIMI NGJA BORDI

Këtë Rregullore e ka miratuar Bordi i FBK-së më 30.08.2023, dhe hyn në fuqi menjëherë pas ditës së miratimit.

Në emër të Bordit Ekzekutiv të FBK-së,

Arben **FETAHU**

Kryetar

Federata e Basketbollit e Kosovës



Prishtinë, 30.08.2023

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:

